

# SYLLABUS

## E DREJTA ROMAKE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta private romake
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i parë, Semestri Veror
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr. Ardit Gashi
Detajet kontaktuese:	E-mail: <a href="mailto:ardrit.gashi@uni-pr.edu">ardrit.gashi@uni-pr.edu</a> Konsultimet: <i>E martë ora 10:00 – 12:00;</i> <i>E enjte ora 14:00 – 16:00 .</i>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Sistemi juridik një vendi nuk do të mund të kuptohet në mënyrë të mirëfilltë nëse ai studiohet ndaras nga historia dhe origjina e tij.</p> <p>E drejta romake quhet e tillë për shkak se u zhvillua përgjatë shekujve të dominimit të Perandorisë Romake (500 vite para erës së re dhe 500 vite pas erës së re). Pra, e drejta romake nënkupton një sistem rregullash dhe parimesh që përfshinte të drejtën e shkruar dhe të pashkruar (që bazohet në tradita/zakone) dhe legjislacionin e qytetit të Romës, po ashtu, që përfshinte legjislacionin e asambleve, vendimet e senatit, aktet e perandorëve, dekretet e pretorëve, shkrimet e juristëve dhe kodet e perandorëve të mëvonshëm.</p> <p>E drejta romake e cila mësohet në këtë kurs të ligjëratave paraqet vetëm të <b><i>drejtën private romake</i></b>, dhe jo të drejtën penale romake, të drejtën administrative romake, etj.</p> <p>E drejta private romake paraqet bazamentin substancial të jurisprudencës të shumicës së vendeve evropiane dhe më larg. Kjo disipline edhe pse historike tashmë, bazohet kryesisht në faktin se është baza e kodifikimeve civile evropiane kontinentale dhe pastaj përmes këtyre kodeve është përhapur edhe më tej në të gjithë botën.</p>

<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi kryesor i lëndës është që studentëve të ju ofrohen njohuri lidhur me institutet juridike fundamentale të së drejtës private romake. Duke filluar nga e drejta personale apo e drejta sa i përket personave; e drejta në lidhje me sendet dhe e drejta lidhur me paditë apo aplikimin e tyre në rastet kur shkeleshin të drejtat subjektive civile.
---------------------------	--

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Studentët do të fitojnë njohuri thelbësore teorike lidhur me lëndën dhe institutet juridike të së drejtës private romake.</p> <p>Studentët do të kenë një pasqyrë të qartë për statusin e lëndës të së drejtës private romake, rolin dhe rëndësinë e saj didaktike.</p> <p>Studentët do të mësojnë për konceptet bazike filozofike të së drejtës në përgjithësi, duke filluar nga <i>ius; actio; lex; iurisprudentia; iura; ipso iure; ipso factum;</i> etj.</p> <p>Studentët do të fitojnë njohuri të mjaftueshme lidhur me disa institute juridike nga e drejta familjare, e drejta pronësisë, e drejta e detyrimeve dhe e drejta trashëgimore, të cilat ende iu kemi prezentë në mënyrë të modernizuar në sistemonin tone juridik</p> <p>Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë se kur bëhet fjalë për një institut juridik nga e drejta private moderne, të identifikojnë origjinën e tij në të drejtën romake.</p> <p>Studentët do të kenë të qartë po ashtu procedurat civile të cilat mund të zhvillohen në rast cenimit të drejtave nga marrëdhëniet juridike civile dhe sipas cilave padive juridike.</p>
---	--

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	Javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	Javë	30
Punë praktike	/	/	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	Javë	/
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiime, seminare	1	15 Javë	/
Detyra të shtëpisë	/	/	/

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	/	/	/
Përgatitja përfundimtare për provim	3	30 ditë	90
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	/	/	/
Projektet, prezantimet, etj.	1	15 Javë	/
<b>Totali</b>	<b>12</b>	<b>15 Javë</b>	<b>165</b>

<p><b>Metodologjia e mësimdhënies:</b></p>	<p>Ligjëratat do të ofrohen sipas metodave dhe standardeve me te avancuara në fushën e studimeve të së drejtës. Si e metoda bazike apo themelore do të jenë metoda ligjërimit, metoda interaktive, dhe metoda historike e studimit të ngjarjeve, metoda analitike.</p> <p>Metoda e ligjërimit do të mundësoj që studentët marrin njohuritë drejtpërdrejt nga lënda e të drejtës private romake. Ligjërimit do të përfshijë një trajtim dhe diskutim të gjerë teorik doktrinar dhe praktik për të gjitha institutet e të drejtës private romake.</p> <p>Përmes metodës interaktive synohet angazhimi i studentëve në fitimin e shkathtësive argumentuese dhe retorike që studentet të paraqesin pikëpamjet dhe botëkuptimin e tyre lidhur me të drejtën romake. Në këtë kuptim do të praktikohen edhe punimet seminarike dhe prezantimet. Studentët do të inkurajohen për studimin e ndonjë teme apo instituti juridik nga e drejta romake.</p> <p>Metoda historike e studimit të instituteve juridike, po ashtu paraqet një rëndësi të posaçme sidomos për lëndën e të drejtës romake. Institutet juridike dhe shembujt nga e drejta romake do të mundësojnë që studentët të arrijnë një shkallë me të gjerë të kuptimit të tyre dhe zhvillimit të aftësive të tyre në interpretimin e ligjit. Përmes kësaj metode, në instancën e fundit studentet do të jenë në gjendje që të identifikojnë normën juridike relevante për marrëdhëniet juridike.</p>
<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<p>Vlerësimi i studentit do të bazohet në gjithë aktivitetin dhe angazhimin e tij hulumtues dhe didaktik, si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>Vijueshmëria në ligjërata dhe diskutimet në klasë – 10%;</i></li> </ol>

	<p>2. Punimi seminarik dhe prezantimi – 10%-20%;</p> <p>3. Testi I (kollokfiumi I) – 35%</p> <p>4. Testi II (kollokfiumi II) – 35%</p> <p><b>Për të kaluar provimin nevojiten së paku 55 pikë.</b> 55- 64 pikë/nota 6; 65-74 pikë/nota 7; 75-84 pikë/nota 8; 85-94 pikë/nota 9; 95-100/nota 10</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Asllan Bilalli &amp; Bedri Bahtiri, <i>E drejta Romake</i>, Prishtinë, 2015.</li> <li>- Asllan Bilalli, <i>Fjalor me Shpjegime latinisht-shqip</i>, Prishtinë 2015.</li> <li>- Ardit Gashi, Avni Puka, Iset Morina, Nebojša Boričić, Visar Morina, <i>FJALOR JURIDIK – E drejta private, publike dhe penale</i>, Iset Morina (ed.), Prishtinë, 2019;</li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ivo Puhan, <i>E drejta romake</i>, Prishtinë, 1988.</li> <li>- Andrew Borkowski &amp; Paul du Plessis, <i>Textbook on Roman Law</i>, Oxford University Press, 2005.</li> <li>- Barry Nicholas &amp; Ernest Metzger, <i>An Introduction to Roman Law</i>, Oxford University Press, 2008.</li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Javët</b>	
<b>Java e parë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njoftimi me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimit gjatë semestrit dhe literaturën.</li> <li>- Vështrim i përgjithshëm i shtetit dhe të drejtës romake. Rëndësia dhe ndikimi i së drejtës romake.</li> <li>- Periodizimi dhe ndarja e së drejtës private romake. Burimet e së drejtës romake:</li> <li>- Periudha e së drejtës së lashtë, klasike dhe postklasike.</li> </ul>
<b>Java e dytë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Subjektet e së drejtës.</li> <li>- Zotësia juridike dhe zotësia e veprimit.</li> <li>- Fitimi, përmbajtja, kufizimi dhe humbja e zotësisë juridike.</li> <li>- Zotësia e veprimit të personave fizik.</li> <li>- Personat juridik.</li> </ul>
<b>Java e tretë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Familja romake, pozita juridike e anëtarëve të familjes. <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>E drejta martesore:</i></li> <li>- <i>Kushtet për lidhjen e martesës.</i></li> <li>- <i>Pengesat për lidhjen e martesës,</i></li> <li>- <i>Fejesa,</i></li> <li>- <i>Format për lidhjen e martesës,</i></li> <li>- <i>Marrëdhëniet personale dhe pronësore mes bashkëshortëve,</i></li> </ul> </li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Zgjidhja e martesës,</i></li> <li>- <i>Tutoria dhe kujdestaria,</i></li> <li>- <i>Llojet e tutorisë dhe kujdestarisë.</i></li> </ul>
<b>Java e katërt:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni i sendit.</li> <li>- Marrëdhëniet sendore-juridike.</li> <li>- Llojet e sendeve.</li> <li>- Posedimi.</li> <li>- Mbrojtja e posedimit.</li> <li>- Kuptimi i pronës private dhe përmbajtja e saj.</li> <li>- Kufizimet.</li> <li>- Llojet e pronës private.</li> </ul>
<b>Java e pestë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fitimi i pronësisë.</li> <li>- Mënyrat e fitimit të pronësisë.</li> <li>- Mjetet juridike për mbrojtjen e pronësisë.</li> <li>- Humbja e pronësisë.</li> </ul>
<b>Java e gjashtë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të drejtat sendore mbi sendet e huaja.</li> <li>- Servituti.</li> <li>- Pengu.</li> </ul>
<b>Java e shtatë:</b>	<i>Provimi i ndërmjetëm (Kollokfiumi i I)</i>
<b>Java e tetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhëniet e detyrimeve.</li> <li>- Subjektet e marrëdhënieve të detyrimeve.</li> <li>- Përfaqësimi.</li> <li>- Ndërrimi i subjekteve.</li> </ul>
<b>Java e nëntë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmbajtja e detyrimeve, elementet esenciale.</li> <li>- Elementet jo esenciale.</li> <li>- Sigurimi i aktiveve.</li> <li>- Sigurimi real dhe ai personal.</li> <li>- Shuarja e detyrimeve.</li> <li>- Përmbushja e detyrimeve dhe pasojat e mos përmbushjes së detyrimeve.</li> </ul>
<b>Java e dhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontrata si burim detyrimesh, kuptimi dhe klasifikimi i kontratave.</li> <li>- Kontratat reale dhe konsensuale: <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>huaja,</i></li> <li>- <i>huapërdorja,</i></li> <li>- <i>depozita,</i></li> <li>- <i>pengu,</i></li> <li>- <i>shitblerja,</i></li> <li>- <i>qiraja,</i></li> <li>- <i>kontrata në vepër.</i></li> </ul> </li> </ul>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Deliktet si burime detyrimesh.</li> <li>- Detyrimet të cilat krijohen nga bazat tjera të ndryshme.</li> </ul>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhëniet trashëgimore-juridike.</li> <li>- Mënyrat e thirrjes në trashëgim.</li> <li>- Trashëgimia ligjore.</li> <li>- E drejta e domosdoshme e trashëgimit.</li> <li>- Fitimi i trashëgimit.</li> </ul>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trashëgimia testamentare dhe llojet e testamentit</li> </ul>
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptimi dhe krijimi i procedurës civile.</li> <li>- Procedura <i>Legis actio</i>, Organet e Procedurës <i>legis actio</i>.</li> </ul>

	<p>Procedura <i>in iure</i> dhe <i>apud iudicem</i>.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aktgjykimi, anulimi i aktgjykimit, Ekzekutimi i aktgjykimit.</li> <li>- Mjetet e jashtëzakonshme për mbrojtjen e të drejtave subjektive, <i>Interdiktet</i>.</li> <li>- Procedura Ekstraordinare.</li> </ul>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<i>Provimi i ndërmjetëm (Kollokfiumi i II)</i>
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<p>Studentët janë të obliguar që të vijojnë ligjëratat, ushtrimet si dhe të gjitha aktivitetet gjatë gjithë semestrit, e gjithashtu duhet tu përmbahen dispozitave të Statutit dhe Kodit të Etikës.</p>	